

Vlerësim mbi HIV/AIDS tek të rinjtë e Komunitetit Romë.

1. Qëllimi:

Qëllimi i kryerjes së këtij vlerësimi ishte përshkrimi i sjelljeve të rrezikshme mes të rinjve të Komunitetit Romë, dhe pasojat që këto sjellje mund të kenë në shëndetin e tyre.

2. Metoda

Vlerësimi u krye në katër qytete të ndryshme të vendit: Tiranë, Vlorë, Fier dhe Korçë. Këto qytete u zgjodhën në përputhje me praninë e Komunitetit Romë në to . Vlerësimi konsistoi në kryerjen e një vëzhgimi bazuar në pyetësorë. Çdo i ri romë u ftua të plotësonte një pyetësor. Për ata që ishin analfabetë pyetësori u plotësua me ndihmën e personit në kontaktit. Pyetësori i përdorur ishte i njëjtë me pyetësorin e përdorur me personat vulnerabël gjatë studimit RAR.

Vëzhgimi u drejtua nga një person kontakti i cili vinte nga ky komunitet dhe të cilit i ishin dhënë paraprakisht disa materiale dhe informacione bazë mbi HIV/AIDS si dhe kërkimet kualitative.

Rekrutimi i pjemarrësve u bë në bazë të vëzhgimeve paraprake në secilin nga këto qytete si dhe me sugjerimet e vetë drejtuesve të Komunitetit Romë, të cilët u kontaktuan kohë më parë se të fillonte vëzhgimi.

3. Rezultatet

Në total pranuan t'u përgjigjeshin pyetjeve të pyetësorit 74 të rinj nga Komuniteti Rom të cilët i përkisnin grupmoshës 14-24 vjec. 54 nga të cilët meshkuj (73%) dhe 20 femra (27 %).

Sipas qyteteve dhe gjinisë (M/F) ishin : 14 në Fier (11/3), 35 në Vlorë (28/7), 14 në Vlorë (6/8) si dhe në Korçë 11 persona (9/2).

Sjellja e përdoruesve të drogës

- Rreth 16% (12 nga 74) të të intervistuarve kishin marrë të paktën një herë drogë.
- Mosha më e shpeshtë kur kishin marrë për herë të parë drogë ishte 16 vjeç (grupmosha 13-18 vjeç)
- Vëndet e përdorimit më të shpeshtë të drogave .

Vëndet	Rrugët	Bar kafetë	Shtëpi
% (n)	58% (7)	25% (3)	17% (2)

n= frekuencë

- Drogat më të përdorura gjatë muajit të fundit

Drogat	Kanabis	Alkooli	Kokaina
% (n)	83% (10)	25% (3)	8% (1)

n=frekuencë

- Rreth 50% e atyre që ishin përdorues droge (6 nga 12 të intervistuar) kanë marrë dy ose më shumë lloje drogash në të njëjtën kohë.
- 25 e të intervistuarve , të cilët kanë përdorur drogë kanë pasë mardhënie seksuale nën ndikimin e drogave.
- Asnjë nga të intervistuarit nuk ka marrë droga në rrugë intravenoze.

Sjelljet seksuale

- 63 % e të intervistuarve (47 nga 74) kanë pasë mardhënie seksuale. Të ndarë sipas gjinisë 57% e meshkujve (31 nga 54) dhe 80% e femrave (16 nga 20) kanë pasë mardhënie seksuale.
- Moshë mesatare në të cilën kanë pasur mardhënien e parë seksuale është 16 vjeç (grupmosha 11-20 vjeç).
- Numri i partnerëve seksual që kanë patur gjatë vitit të fundit

Nr i partnerëve	1	2	>3
Total % (n)	53% (25)	28% (13)	17% (8)

- 50% e të intervistuarve nuk kanë përdorur asnjëherë perzevativë gjatë mardhënieve seksuale dhe 43 % i kanë përdorur “ ndonjëherë” vetëm 7% përdorin gjithmonë perzevativë gjatë mardhënieve të tyre.

Arsyet e mos përdorimit të kontraceptivëve

Arsye	%
Nuk u pëlqen seksi me preservative	43 %
I besojnë partnerit	26 %
E kanë të vështirë për t'a përdorur	14 %
E kanë të vështirë t'i kërkojnë partnerit t'a përdorë	6 %

- 28% (21) e të intervistuarve kanë patur mardhënie seksuale me dikë në këmbim të parave, drogës etj, nga këta 19 janë meshkuj (61% e meshkujve të intervistuar).

Pasojat dhe kujdesi shëndetësor.

- Vendet ku mund të merret informacioni mbi HIV dhe SST-të

Vendet ku mund të merret informacion	% frekuenca
Media	49%
Shokët/ bashkëmoshatarët	20%
Asnjë informacion	14 %
Familja	7 %
Shkolla	5 %

- 3 % e të intervistuarve mendojnë se riskohen nga HIV dhe SST e tjera.
- 10 % (7) e të intervistuarve kanë kryer testing e HIV/AIDS.
- Anjë nga ata nuk ka kryer testing për Hepatitin B ose Hepatitin C
- 5 % e të intervistuarve kanë patur në të kaluarën sëmundje seksualisht të transmetueshme.

Konteksti

- Niveli i edukimit

Niveli edukimit	Pa ars imuar	Arsim fillor	Arsim i mesëm
%	65 %	32 %	3 %

4. Diskutim

Përqindja e femrave që morën pjesë në këtë vlerësim dhe që i përkasin Komunitetit Romë është më e vogël se ajo e meshkujve. Ky raport reflekton vështirësitë e hasura për të pasur akses të plotë në këtë popullatë gjatë gjithë kryerjes së vëzhgimit. Përqindja e të rinjve romë të cilët rezultojnë përdorues drogë është vetëm 16 %, një shifër kjo më e ulët se përqindja e të rinjve të tjerë vulnerabël që përdorin drogë dalë nga konkluzionet e RAR.

Numri relativisht i vogël i personave të intervistuar (74 të rinj) mund të ketë influencuar në rezultate. Në të njëjtën kohë, më tepër se gjysma e atyre që kanë përdorur drogë kanë marrë dy ose më shumë lloje drogash në të njëjtën kohë. Kjo gjë tregon se ky grup është i ekspozuar shumë ndaj rrezikut të përdorimit të drogës.

Të rinjtë romë fillojnë përdorimin e drogës në një moshë relativisht të re (16 vjec), fillimisht me kanabis sativa. Asnjë nga të intervistuarit nuk ka përdorur droga që meeren me rrugë intravenoze. Megjithatë ne duhet të tregohemi të kujdesshëm ndaj përgjithësimin të këtyre konkluzioneve për të tërë komunitetin e të rinjve romë.

Rezulton se një e katërta e personave përdorues të drogës kanë patur mardhënie seksuale nën efektin e drogave, gjë që rrit sjelljet e rrezikshme për këtë nën-grup.

Të rinjtë romë përfaqësojnë relativisht një grup seksualisht shumë aktiv. (rreth 2/3 e të intervistuarve) kanë patur mardhënie seksuale. Për t'u vënë re është fakti se 80% e femrave të intervistuarja janë seksualisht aktive, kjo gjë marrë në konsideratë gjatë

hartimit ë projekteve për ndërhyrje në këtë popullatë. Edhe vetë fakti i moshës së hershme të fillimit të marrëdhënieve seksuale (16 vjeç) mbështet atë cka thanë më sipër. Në këtë drejtim gjithashtu ë shpie edhe fakti që rreth gjysma e atyre që kanë patur marrëdhënie seksuale, kanë patur gjatë vitit të fundit 2 ose më shumë partnerë.

Niveli relativisht i lartë i sjelljeve të rrezikshme seksuale është në kontrast me nivelin e ulët të paraqitur në drejtim të mbrojtjes së sjelljeve seksuale , psh niveli i ulët i përdorimit të perzevativëve (vetëm 7% rezultojnë se përdorin rregullisht perzevativë) .

Si edhe çdo grup tjetër i riskuar, të rinjtë romë nuk përdorin perzevativë pasi kryesisht ata nuk parapëlqejnë të kenë seks me perzevativë si dhe pasi ata shprehen se kanë besim tek partneri i tyre.

Niveli i ulët i mbrojtjes të marrëdhënieve seksuale mund të lidhet gjithashtu me nivelin e ulët të njohjes dhe perceptimit të rrezikut që ata kanë rreth HIV/AIDS dhe SST-ve.

Si dhe për të gjitha grupet e tjera ë riskuara burimi kryesor i informacionit lidhur me HIV/AIDS dhe SST mbeten media dhe shoqët, në të njëjtën kohë shkolla dhe familja konsiderohen si burime më pak të rëndësishme informacioni.

Përqindja relativisht e lartë e personave të cilët kanë kryer testing e HIV (10%) nuk mund të lidhet as me perceptimin e rrezikut që ata kanë (i cili është shumë i ulët) as edhe me një akses të mirë që ata mund të kenë në shërbime. Ky fakt mund të lidhet me arsye të tjera, si psh ; dhurimi i gjakut, sic është e ditur një numër i madh personash nga komuniteti romë janë dhurues të rregullt të gjakut. (dhënia e gjakut me qëllime fitimi).

Përqindja e vogël e atyre që pranojnë që kanë patur sëmundje seksualisht të transmetueshme mund ë lidhet me nivelin e ulët të njohurive dhe edukimit ë tyre shëndetësor, gjë që shpie në një perceptim dhe ndërgjegjësim ë ulët ndaj shenjave dhe simptomave të SST-ve.

Pothuajse gjysma e atyre që kanë patur marrëdhënie seksuale në të kaluarën, kanë patur kryesisht marrëdhënie seksuale në këmbim të parave, drogave apo favorizimeve të tjera të cilat lidhem me nivelin e tyre të ulët social dhe ekonomikdhe që mund të influencojnë në sjelljet e tyre të rrezikshme. Kjo mbështetet gjithashtu edhe nga fakti se pothuajse 2/3 e të intervistuarve janë analfabetë, e dhënë kjo që duhet marrë në konsideratë kur të hartohen ndërhyrjet për parandalimin e HIV në këtë komunitet.